

## MARRËVESHJE

### PER SHITJEN DHE BLERJEN E 66% TË KAPITALIT TË REGJISTRUAR

### TË SHOQËRISË “NOSHI” SHPK.

Sot në Tiranë, më datë 20 / 08 /2018, kjo Marrëveshje u nënshkrua:

#### NGA DHE NDËRMJET


1. **Arian Musa**, I biri i Gjencit, i lindur më 25/02/1964 në Kukës dhe banues në Tiranë, Shqipëri, identifikuar me kartë identiteti nr 028965783 dhe nr personal G40225239Q, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar ( në vijim “**shitësi**”),

DHE

2. “**AIMA**” **SHA** me NUIS K11828002J, krijuar më 19/05/2001, me Aksionar të vetëm Arian Musa, dhe adresë Durrës Nikël Rinas Hertz Piazza, Lagjanr 1, Rruga Rinas Aeroport, Godina Nr 56/15, me kapital të nënshkruar 30 290 000 lekë, përfaqësuar nga Aksionari i vetëm Arian Musa dhe nga Administratore Sadete Musa , madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar ( në vijim “**blerësi**”),

#### MEQENËSE:

- A) Më **06/02/1995** është themeluar rregullisht shoqëria “**NOSHI**” SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e së drejtës shqiptare, me seli në Kashar Autostrada Tiranë Durrës km 7, Tiranë, Shqipëri, me NIPT nr. J91524007E, sipas ekstraktit elektronik të regjistrimit tregtar marrë nga faqja zyrtare e web të QKB bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje, (në vijim, “**Shoqëria**”).
- B) Kapitali i regjistruar i shoqërisë është **95 745 000 lekë**, i përbërë nga 2 (dy) kuota në zotërim të:
  - Arian Musa zotërues i 1 (një) kuote , e cila përfaqëson 66% (gjashtëdhjet e gjashtë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.



- Gazmend Haxhia zotërues i 1 (një) kuote , e cila përfaqëson 34% (tridhjet e katër për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- C) Shitësi ka shprehur qëllimin e tij për shitjen e Kuotës që zotëron në kapitalin e Shoqërisë dhe transferimin e të drejtave të pronësisë në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshje.
- D) Blerësi ka shprehur qëllimin e tij për blerjen e Kuotës të Shitësit në kapitalin e Shoqërisë dhe përfitimin e të drejtave të pronësisë në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshje.
- E) Shitësi dhe Blerësi vendosin në vijim, në mënyrë të detajuar afatet dhe kushtet e shitblerjes së Kuotave në kapitalin e Shoqërisë.

**ATËHERË,** në vijim të Parashtrimeve, të cilat përbëjnë një pjesë integrale, thelbësore dhe detyruese të kësaj marrëveshje dhe mbi bazën e premtimeve, angazhimeve, deklarimeve dhe garancive, detyrimeve dhe kushteve respektive të kësaj marrëveshje, Palët premtojnë dhe bien dakord për sa vijon.

## **NENI I**

### **PARASHTRIMET, ANEKSET DHE PERKUFIZIMET**

#### **1.1 Parashtrimet dhe Anekset**

Parashtrimet e lartpërmendura dhe Anekset e listuara më poshtë përbëjnë pjesë integrale dhe thelbësore të kësaj Marrëveshje:

- (i) **Aneksi A:** Kopje e kartës së identitetit të Arian Musa;
- (ii) **Aneksi B:** Kopje e NUIS -it të **“AIMA” SHA** me NUIS K11828002J;
- (iii) **Aneksi C:** Ekstrakti elektronik i regjistrimit tregtar të Shoqërisë marrë nga faqja zyrtare web e QKB.

## **NENI II**

### **SHITJA DHE BLERJA E KUOTAVE**

#### **2.1 Transferimi i Kuotave**

Në përputhje dhe në zbatim të afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshje, Shitësi merr përsipër ti shesë Blerësit, i cili merr përsipër të blejë nga Shitësi dhe të bëhet zotërues i kuotës që përfaqëson 66 % (gjashtëdhjetë e gjashtë për qind) të kapitalit të Shoqërisë.



Për rrjedhojë, me Mbylljen e kësaj Marrëveshje Shoqëria do të zotërohet nga ortakët :

- “AIMA” SHA **me NUIS K11828002J** zotërues i 1 (një) kuote , e cila përfaqëson 66% (gjashtëdhjet e gjashtë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- Gazmend Haxhia zotërues i 1 (një) kuote , e cila përfaqëson 34% (tridhjet e katër për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

Kuota blihet nga Blerësi e lirë dhe pa asnjë Peng të regjistruar, për rrjedhojë nga Data e Marrëveshjes, Blerësit i jepen të gjitha të drejtat që lidhen me Kuotën, duke përfshirë por pa u kufizuar tek, e drejta e votës dhe çdo e drejtë tjetër mbi dividendin e pagueshëm ose aktualisht e paguar pas Datës së Marrëveshjes, nëse ka.

Kuota e Shoqërisë transferohet me të gjithë asetet përkatëse ose ato që lidhen me to që zotërohen ose përdoren nga Shoqëria në lidhje me aktivitetin e saj tregtar, duke përfshirë por pa u kufizuar në marrëveshje mirëbesimi, kontrata në vazhdimësi, pajisje teknike, servera, software dhe hardware etj. si edhe çdo e drejtë e arrirë përpara ose pas Datës së Marrëveshjes.

## 2.2 Çmimi i Blerjes dhe afatet e pagesës

Çmimi i blerjes që Blerësi u detyrohet Shitësve për blerjen e Kuotës është rënë dakord dhe miratuar nga Palët në shumën e përgjithshme prej 63 191 700 ALL (Gjashtëdhjetëe tremilion e njëqindnëntëdhjetenjë mijë e shtatëqind lekë) (në vijim “**Çmimi i Blerjes**”)

Çmimi i Blerjes nuk do të mund të jetë objekt i asnjë ndryshimi midis Palëve.

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Blerësi bie dakord t’i shlyej Shitësit Çmimin e Blerjes të rënë dakord si më sipër.

## NENI III

### MBYLLJA

## 3.1 Data e Mbylljes



Mbyllja e transaksionit të transferimit të Kuotave sipas kësaj Marrëveshje do të kryhet në Datën e Marrëveshjes.

### **3.2 Veprimet e mbylljes dhe dorëzimet**

Në datën e Mbylljes, Palët do të kryejnë të gjithë veprimet e mëposhtme, dorëzimet, dhe formalitetet, përveç çdo veprimi tjetër që kërkohet të kryhet në Datën e Mbylljes sipas kësaj Marrëveshje.

#### *3.2.1 Veprimet e Shitësit*

Shitësi bie dakort dhe zotohet se do të:

- (i) marri pjesë dhe votoj në mbledhjen e asamblesë së Shoqërisë për miratimin e transferimit të Kuotave të kësaj Marrëveshje;
- (ii) dorëzoj te Blerësi të gjithë dokumentacionin përkatës të Shoqërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në dokumentacionin ligjor, kontabël, tatimor, financiar, bankar, administrativ, korrespondencat e ndryshme, si dhe çdo dokument tjetër që i përket dhe/ose ka lidhje në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me Shoqërinë, në format të shtypur, elektronik ose tjetër, origjinal apo kopje, të ndodhur në ambientet e Shoqërisë apo jashtë saj.

#### *3.2.2 Veprimet e Blerësit*

Blerësi bje dakord dhe merr përsipër të paguajë Çmimin e Blerjes Shitësit brenda afatit të parashikuar në këtë Marrëveshje.

### **3.3 Një transaksion i vetëm**

Të gjitha veprimet dhe transaksionet që do të kryhen në datën e Mbylljes siç parashikohen në këtë Marrëveshje do të konsiderohen si një transaksion i vetëm në mënyrë që, sipas zgjedhjes së Palës e cila është e interesuar të kryejë një veprim apo transaksion, asnjë veprim apo transaksion nuk do të konsiderohet të jetë kryer derisa të gjithë veprimet dhe transaksionet që do të kryen deri në datën e Mbylljes siç parashikohen në këtë Marrëveshje do të jenë kryer siç parashikohen në Marrëveshje.



### 3.4 Dorëzimi i Dokumenteve

Brenda 2 (dy) ditëve pune nga data e Mbylljes, Shitësi do ti dorëzoj Blerësit të gjithë dokumentet e Shoqërisë siç është parashikuar në këtë Marrëveshje.

## NENI IV

### DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

#### 4.1 Deklarimet dhe garancitë e Shitësit

Shitësit japin në favor të Blerësit deklarimet dhe garancitë si vijon të cilat janë dhe do të jenë të vërteta, të drejta dhe korrekte duke filluar nga data e Mbylljes, duke përjashtuar ato deklarime dhe garanci të cilat në mënyrë të shprehur i referohen një date të specifikuar dhe duhet të konsiderohen të vërteta, të drejta dhe korrekte ekskluzivisht për atë datë specifike.


Shitësit njohin dhe bien dakord se:

- (A) Shitësit japin vetëm deklarimet dhe garancitë e parashikuara në këtë nen të Marrëveshjes dhe asgjë tjetër; dhe
- (B) Deklarimet dhe garancitë e parashikuara në këtë nen të Marrëveshjes zëvendësojnë çdo lloj garancie apo zgjidhje tjetër që parashikohet nga legjislacioni Shqiptar në rastin e marrëveshjeve të shit-blerjeve dhe përbën të vetmin burim përgjegjësie të Shitësit për detyrimet që ai ka marrë përsipër sipas kësaj Marrëveshje kundrejt Blerësit; për rrjedhojë Blerësi heq dorë nga çdo veprim apo zgjidhje që mund t'i jap të drejtë të kërkojë apo ushtrojë pas datës së Mbylljes në lidhje me ato mospërbushje, përfshirë dhe veprimin e zgjidhjes së kësaj Marrëveshje.

#### 4.2 Deklarimet dhe garancitë në lidhje me Shitësin

##### 4.2.1 Aftësia e Shitësit

Shitësi ka fuqi dhe aftësi të plotë ligjore veprimi të nënshkruaj këtë Marrëveshje dhe të zbatoj detyrimet e saj edhe për llogari të Shoqërisë deri në masën e përcaktuar në këtë Marrëveshje.



Shitësi ka të gjitha të drejtat dhe autoritetin e duhur të lidhi këtë Marrëveshje dhe të përmbushi detyrimet që lindin prej saj si dhe kryejnë transaksionet që përfshihen në këtë Marrëveshje.

Të gjitha veprimet dhe formalitet që i kërkohen Shitësit në mënyrë që të nënshkruaj këtë Marrëveshje dhe përmbushin detyrimet e saj janë kryer menjëherë dhe rregullisht. Kjo Marrëveshje nënshkruhet nga Shitësi dhe do të jetë e detyrueshme kundrejt Shitësit në përputhje me afatet dhe detyrimet që ajo përmban.

#### *4.2.2 Asnjë konflikt*

Nënshkrimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshje nuk përbën shkelje të statutit të Shoqërisë apo ndonjë detyrimi kontraktor të tyre ose ndaj ndonjë vendimi, apo ekzekutimi dhe urdhra të lëshuara nga ndonjë autoritet kundër Shitësit që mund të ndikojë në vlefshmërinë, zbatueshmërinë dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshje.

#### *4.2.3 Miratimi*

Nënshkrimi dhe zbatimi nga Shitësi i kësaj Marrëveshje nuk kërkon dhe nuk do të kërkojë që Shitësi të marrë ndonjë aprovim, miratim, autorizim, licencë, leje, urdhër, apo të kryejnë ndonjë depozitim, ose njoftim kundrejt ndonjë autoriteti.

#### *4.2.4 Mungesa e ndërmjetësuesve*

Shitësit nuk kanë lidhur asnjë marrëveshje dhe nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim e cila mund të ngre pretendime të palëve të treta kundrejt Blerësit për pagimin e komisioneve apo tarifave të ndërmjetësimit ose pagesa në lidhje me nënshkrimin dhe përfundimin e kësaj Marrëveshje.

### **4.3 Deklarimet dhe garancitë në lidhje me Shoqërinë**

#### *4.3.1 Themelimi dhe autoriteti i Shoqërisë*

Shoqëria është një shoqëri shqiptare e themeluar rregullisht dhe që vepron sipas ligjeve të Shqipërisë dhe nuk është objekt i ndonjë procedure falimenti apo likuidimi.



#### 4.3.2 *Librat dhe shënimet e Shoqërisë*

Librat dhe shënimet e Shoqërisë janë të vërteta dhe të plota në të gjithë aspektet materiale të tyre në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.

#### 4.3.3 *Statuti i Shoqërisë*

Statuti në fuqi i Shoqërisë është përpiluar në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.

#### 4.3.4 *Pasqyrat financiare dhe mungesa e përgjegjësive të Shoqërisë*

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në përputhje me principet e kontabilitet dhe Ligjin e Zbatueshëm dhe janë të vërteta, korrekte dhe të plota dhe paraqesin në mënyrë të drejtë dhe saktë gjendjen financiare të Shoqërisë në datën e kësaj Marrëveshje.

Në Datën e Mbylljes, Shoqëria nuk do të ketë asnjë detyrim të lënë pezull, me përjashtim të:

(A) Detyrimeve të pasqyruara në Pasqyrat Financiare; dhe

(B) Detyrimet gjatë rrjedhës normale të biznesit deri në datën e Mbylljes.

#### 4.3.5 *Çështjet gjyqësore*


Shoqëria nuk është e përfshirë në asnjë proces gjyqësor, arbitrazhi me karakter penal.

## NENI V

### DEKLARIME DHE GARANCI TË BLERËSIT

#### 5.1 **Deklarime dhe garanci të Blerësit**

Blerësi jep në favor të Shitësit deklaramet dhe garancitë e mëposhtme, të cilat janë dhe do të jenë të vërteta, pra Blerësi deklaron se :



- disponon te gjithë informacionin e duhur ne lidhje me aktivitetin e Shoqerise menyren e organizimit dhe funksionimit te saj, marredhenjet me te tretet dhe çdo informacion tjetër i nevojshem qe kushtezon permbushjen e objektit te kesaj kontrate ,
- deklaron se nuk ka asnje pretendim as tani dhe as ne te ardhmen ndaj Shitesit.

## NENI VI

### TË NDRYSHME

#### 6.1 Marrëveshja

Kjo Marrëveshje përcakton të gjithë marrëveshjen dhe mirëkuptimin mes Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson çdo marrëveshje apo deklaratë të mëparshme.

#### 6.2 Ndryshimet

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshje nuk do të konsiderohet i vlefshëm, përveç kur është rënë dakord në mënyrë të shkruar nga Palët.


#### 6.3 Heqja dorë

Çdo tolerancë ose heqje dorë nga çdo Palë të një shkelje të një dispozite të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të konsiderohet heqje dorë e të drejtave që rrjedhin nga dispozita e shkelur ose e së drejtës për të kërkuar përmbushjen e të gjitha kushteve dhe afateve të parashikuara këtu.

#### 6.5 Konfidencialiteti

Çdo e dhënë, lajm, dokument apo informacion që lidhet me Marrëveshjen, transaksioni i parashikuar këtu, do të konsiderohen si rreptësisht private dhe konfidenciale dhe nuk do t'ju bëhen të ditur palëve të treta (përjashtuar këtu QKB-ën ose ndonjë autoritet tjetër shtetëror), pa marrë miratimin paraprak të shkruar të Palës tjetër, e cila do të bie dakord për çdo komunikim ndaj palëve të treta lidhur me transaksionin parashikuar nga Marrëveshja, pa cënuar komunikimet e detyrueshme të parashikuara nga Ligji i Zbatueshëm.

#### 6.6 Transferimi i Marrëveshjes





Kjo Marrëveshje dhe të drejtat që lindin prej saj, nuk mund t'i transferohen ndonjë personi ose pale të tretë nga asnjëra Palë, pa marrë paraprakisht pëlqimin e shkruar të Palës tjetër.

## 6.7 Njoftimet

Çdo njoftim apo komunikim që do të jepet në zbatim të kësaj Marrëveshje, do të bëhet me shkrim në gjuhën shqipe dhe dorëzohet me poste të regjistruar me kthim përgjigje duke e dërguar paraprakisht me e-mail në adresën të cilën Pala i ka komunikuar Palës tjetër në përputhje me këtë nen.

## 6.9 Ligji i Zbatueshëm

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në bazë të Ligjit të Zbatueshëm.

## 6.10 Gjuha


Kjo Marrëveshje është përpiluar në gjuhën shqipe dhe nënshkruar nga Palët në 4 (katër) ekzemplarë origjinalë.

## 6.11 Zgjidhja e konflikteve

Të gjitha konfliktet që lindin nga apo në përputhje me këtë Marrëveshje do të zgjidhen fillimisht drejtpërdrejtë me mirëkuptim mes Palëve dhe në rast se Palët nuk bien dakord brenda 30 (tridhjetë) ditëve, konfliktet do të zgjidhen nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.



### SHITËSI

Arian Musa



### BLERËSI

“AIMA” SHA

   
Aksionar i vetëm Administrator